



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

KA.nr.617/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtarja Vlora Pacolli-Rexhepi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “ODDO COFEE MORE” (Capelli Shpk) me seli në Prizren, me NUI 810602517, me përfaqësues sipas autorizimit Av.N.M., avokat nga Prizreni, kundër të paditurës Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë-Inspektorati Sanitar i RKS, me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të Vendimit Nr.7193-2 AUV.Ref.04/2-872/2021 të datës 20.10.2021, jashtë seancës me datë 28.03.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. **KONSIDEROHET** e tërhequr padia e paditësit “ODDO COFEE MORE” (Capelli Shpk) me seli në Prizren, kundër të paditurës Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë-Inspektorati Sanitar i RKS, me seli në Prishtinë për shkak të anulimit të vendimit Nr.7193-2 AUV.Ref.04/2-872/2021 të datës 20.10.2021
  
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi ODDO COFEE MORE (Capelli Shpk) me seli në Prizren nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar N.M. avokat nga Prizreni me datën 17.11.2021 ka parashtruar padi, kundër të paditurës Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë-Inspektorati Sanitar i RKS me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të Vendimit Nr.7193-2 AUV.Ref.04/2-872/2021 të datës 20.10.2021

Gjykata me datë 26.02.2024 paditësit “ODDO COFEE MORE” (Capelli Shpk) i ka dërguar vërejtjen për pagesë të taksës, më të cilën e ka ftuar paditësin që brenda afatit prej 15 ditëve nga

marrja e kësaj vërejtje, t'a paguaj taksën gjyqësore për padi, në shumën prej 50 euro, duke e paralajmëruar paditësin se nëse nuk e paguan taksën gjyqësore për padi, brenda afatit të caktuar, do të konsiderohet se padia është tërhequr konform nenin 63 të Ligjit për Konfliktin Administrativ lidhur me nenin 253 par.5 të Ligjit për Procedurën Kontestimore dhe me nenin 5 dhe 6 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore.

Paditësi vërejtjen e taksës gjyqësore e ka pranuar me datë 01.03.2024, ndërsa edhe pas kalimit afatit konstatohet se paditësi nuk ka vepruar sipas vërejtjes për taksë. Andaj, gjykata konsideron se paditësi është tërhequr nga padia, dhe ka vendosur si në pikën I të këtij aktvendimi, duke e përfunduar procedurën në këtë çështje administrative.

Lidhur me shpenzimet procedurale gjykata vendosi në bazë të nenit 64 të LKA-së.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë Departamenti i Përgjithshëm

Ka.nr.617/22, datë 28.03.2024

Gjyqtarja  
Vlora Pacolli Rexhepi

**KËSHILLA JURIDIKE :** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.